



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.19/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT
ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 03/2023 PËR REGJISTRIMIN
LICENCIMIN DHE CAKTIMIN E TAKSËS PËR PRODHUESIT E
MATERIALIT FIDANOR

¹ Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - Nr.19/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 03/2023 për regjistrimin licencimin dhe caktimin e taksës për prodhuesit e materialit fidanor, i nënshkruar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datën 09.08.2024.

Në mbështetje të nenit 3 dhe 24 të Ligjit Nr.2004/13 për Materialin Fidanor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.22/01 Mars 2008), duke marrë parasysh nenin 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, dt. 01 Mars 2019), në pajtim me nenin 9 paragrafi 2 të Rregullore (QKR) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare 21.06/2024), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR)-NR.19/2024
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR)
- NR. 03/2023 PËR REGJISTRIMIN LICENCIMIN DHE CAKTIMIN E TAKSËS PËR
PRODHUESIT E MATERIALIT FIDANOR**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR. 03/2023 për regjistrimin licencimin dhe caktimin e taksës për prodhuesit e materialit fidanor, me qëllim të krijimit të bazës ligjore për zbatimin e akteve nënligjore nga Agjencia për Ushqim dhe Veterinari që i përcaktojnë autoritetin licencues për material fidanor.

Neni 2

Neni 4, paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ bazik, fshihen dhe riformulohen si në vijim:

1. Personat juridik që merren me prodhimin e materialit fidanor duhet të aplikojnë tek Autoriteti kompetent përgjegjës – Agjencia për Ushqim dhe Veterinari.
2. Kriteret që operatorët ekonomik duhet të përmbushin kur aplikojnë për leje si prodhues të materialit fidanor, janë:
 - 2.1. Të jenë të regjistruar në ARBK;
 - 2.2. Të kenë informatën apo dëshminë për analizat fiziko-kimike të tokës - nga IBK ose nga laboratorë tjerë të akredituar – për fidane të pemëve;
 - 2.3. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës;
 - 2.4. Deklaratën mbi prejardhjen e materialit për shumim -nënshartesa dhe mbishartesa;
 - 2.5. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin

e materialit fidanor të pemëve;

3. Kriteret që operatorët ekonomik duhet të përmbushin kur aplikojnë për leje si prodhues të materialit fidanor të hardhisë së rrushit, janë:

3.1. Të jenë të regjistruar në ARBK;

3.2. Të kenë raportin për analiza paraprake të tokës - origjinal nga IBK ose nga laboratorë tjerë të akredituar – për fidane të hardhisë së rrushit;

3.3. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës;

3.4. Deklaratën mbi prejardhjen e materialit për shumim - nënshartesa dhe mbishartesa;

3.5. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;.

4. Kriteret që operatorët ekonomik duhet të përmbushin kur aplikojnë për leje si prodhues të materialit fidanor të bimëve dekorative, janë:

4.1. Të jenë të regjistruar në ARBK;

4.2. Të ketë të punësuar personin, me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës;

4.3. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të bimëve dekorative;

5. Kriteret që operatorët ekonomik duhet të përmbushin kur aplikojnë për leje si prodhues të materialit fidanor të perimeve, janë:

5.1. Të jenë të regjistruar në ARBK;

5.2. Të ketë të punësuar personin me përgatitje profesionale që e dëshmon me diplomë të Fakultetit të Bujqësisë – drejtimi përkatës;

5.3. Procesverbali nga inspektori fitosanitar që dëshmon se posedon fidanishten për prodhimin e materialit fidanor të perimeve;

6. Në sistemin elektronik krijohet forma e licencës elektronike dhe ka vlerën e njëjtë si certifikata fizike e cila mund të shkarkohet nga personi në çdo kohë përmes këtij sistemi.

Neni 3

Neni 5 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 4

Në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ bazik, fjala “Departamenti për Politika Bujqësore dhe Tregje- DPB&T” zëvendësohet me fjalën “Agjencia për Ushqim dhe Veterinari AUV”.

Neni 5

Neni 8 i Udhëzimit Administrativ bazik, fshihet.

Neni 6

Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

